



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-22019 Dt. 25.06.2020

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 81 të Ligjit 04/-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 61.4 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik të plotësuar dhe ndryshuar në prill 2018 dhe nenit 72.1 germa (k) të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 49 i Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës mori këtë:

V E N D I M

I. Emërohet **Adhurim Hoxha** për menaxhimin e kontratës me titull: **“Pastrimi i deponive të egra- Faza e Dytë” në Komunën e Drenasit**, me numër të prokurimit **611-20-041-521**, të datës, **24/06/2020**; Nr: arkivës: **02-400-21826**, që e kryen **Ibrahim Kurrumeli B.I Drenas**, përfaqësuar nga **Ibrahim Kurrumeli, Drejtor**. (Kontraktues)

II. Përgjegjësitë e menaxherit të kontratës në fjalë janë:

Të menaxhojë obligimet dhe detyrat e autoritetit kontraktues të specifikuar me kontratë;
Të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë, ndërsa funksionet e menaxherit të projektit janë obligimet e parapara me normat e nenit 55.20 me nënparagrafet duke filluar nga germa (a) deri tek ajo (k) të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, kurse për punën e tij i raporton Zyrtarit Kryesor Administrativ të Komunës– Kryetarit.

III. Me këtë Vendim do të njoftohen Zyra e Prokurimit, Menaxheri i projektit, Operatori Ekonomik dhe Zyra e Kryetarit.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës;
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë;
- Menaxheri i Projektit;
- Operatorit Ekonomik;
- Arkivit të Komunës së Drenasit;



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci